



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

PROJEKTLIGJ PËR SPORT¹

DRAFT LAW ON SPORTS²

NACRT ZAKONA O SPORTU³

¹ Projektligjit për Sport është aprovuar në mbledhjen e 178 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 07/178, date 13.12.2023;

² Draft Law on Youth on Sports on the 178th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.07/178 dated 13.12.2023;

³ Nacrt Zakon o Sportu usvojen je na 178 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.07/178, datum 13.12.2023

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">LIGJ PËR SPORT</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është organizimi dhe zhvillimi i sportit dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës, në një ambient të sigurt, i cili promovon shëndetin dhe mirëqenien e sportistëve dhe shoqërisë në përgjithësi.</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p style="text-align: center;">LAW ON SPORTS</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Law is the organization and practicing of sports and physical activity in the Republic of Kosovo, in a safe environment that promotes the health and well-being of athletes and society in general.</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O SPORTU</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Svrha ovog zakona je organizovanje i razvoj sporta i fizičke aktivnosti u Republici Kosovo, u bezbednom okruženju koje promovise zdravlje i dobrobit sportista i društva uopšte.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Me këtë ligj përcaktohen rregullat e funksionimit dhe të organizimit të sportit, përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e organizatave dhe institucioneve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e atyre që përfshihen në veprimtaritë sportive dhe aktivitetin fizik.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>This law defines the rules of functioning and organization of sports, the rights and responsibilities of relevant institutions and organizations, as well as the rights and responsibilities of those involved in sports activities and physical activity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Ovaj zakon definiše pravila za funkcionisanje i organizaciju sporta, definiše prava i odgovornosti organizacija i institucija, kao i prava i odgovornosti onih koji se bave sportskim aktivnostima i fizičkom aktivnošću.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Aktivitet fizik – çdo lëvizje trupore e shkaktuar nga muskujt skeletorë që kërkon shpenzim të energjisë;</p> <p>1.2. Trajnim sportiv – ndërmarrja e çfarëdolloj procesi trajnues të sportistit, trajnerit, gjyqtarit dhe personave të tjerë të përfshirë në sport që ka për qëllim zhvillimin e karakteristikave antropologjike dhe aftësive motorike e funksionale, si dhe përvetësimi i aftësive motorike për një sport të caktuar ose degë sportive;</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. The expressions used in this Law have the following meaning:</p> <p>1.1. Physical activity - any movement of the body by skeletal muscles that require energy consumption;</p> <p>1.2. Sports training - the undertaking of any type of training process of the athlete, coach, referee and other persons involved in sports, which aims to develop anthropological characteristics and motor and functional skills, as well as the acquisition of motor skills for a certain sport or sports branch;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Fizička aktivnost – bilo koji pokret tela koji su proizveli skeletni mišići i koji zahtevaju potrošnju energije;</p> <p>1.2. Sportski trening – sprovođenje bilo koje vrste trenažnog procesa sportiste, trenera, sudije i drugih lica koja se bave sportom koji ima za cilj razvoj antropoloških karakteristika i motoričkih i funkcionalnih sposobnosti, kao i sticanje motoričkih sposobnosti za određeni sport ili sportsku granu;</p>

<p>1.3. Lojë tradicionale – formë e aktivitetit fizik e cila ka karakter garues dhe zhvillohet në Republikën e Kosovës, në rajone të ndryshme të territorit të saj apo vetëm në një rajon, që për shkak të historisë së zhvillimit të lojës apo organizimit të garave për një kohë të gjatë dhe që është përcjellur në breza të ndryshëm, konsiderohet lojë tradicionale;</p> <p>1.4. Personi që kryen punë profesionale në sport – trajneri, instruktori, personi zyrtar që organizon dhe udhëheq garë sportive dhe personat tjerë zyrtarë sipas akteve përkatëse të organizatave sportive;</p> <p>1.5. Rekreacion sportiv – aktivitet fizik qoftë i planifikuar dhe programuar ose jo, që ka qëllim zhvillimin e aftësive psiko-fizike dhe shëndetit, pa pjesëmarrje në gara sportive zyrtare;</p> <p>1.6. Ndërmjetësim sportiv – zhvillimi i aktivitetit të ndërmjetësimit ose përfaqësimit të sportistit apo trajnerit në marrëdhënien e tij të punës, si dhe aktiviteti i ndërmjetësimit apo përfaqësimit të klubit sportiv;</p>	<p>1.3. Traditional game - traditional game is considered any form of physical activity which has a competitive character and takes place in the Republic of Kosovo, in different regions of its territory or only in one region, because of the history of the development of the game or the organization of competitions for more than five (5) years in a row;</p> <p>1.4. Person who performs professional work in sports – coach, instructor, official person who organizes and leads sports competition and other official persons according to the relevant acts of sports organizations;</p> <p>1.5. Recreational sports - physical activity whether or not planned or programmed, aimed at developing psycho-physical skills and health, without participation in official sports competitions;</p> <p>1.6. Sports mediation – carrying out the activity of mediation or representation of the athlete or coach in his or her work relationship, as well as the activity of mediation or representation of the sports club;</p>	<p>1.3. Tradicionalna igra– oblik fizičke aktivnosti koji ima takmičarski karakter i odvija se u Republici Kosovo, u različitim regionima njene teritorije ili samo u jednom regionu, zbog istorije razvoja igre ili organizovanja takmičenja već duže vreme i da je prenošena na različite generacije, smatra se tradicionalnom igrom;</p> <p>1.4. Lice koje obavlja stručne poslove u sportu – trener, instruktor, službeno lice koje organizuje i vodi sportsko takmičenje i druga službena lica prema relevantnim aktima sportskih organizacija;</p> <p>1.5. Sportska rekreacija – fizička aktivnost bila planirana i programirana ili ne, u cilju razvoja psiho-fizičkih sposobnosti i zdravlja, bez učešća u zvaničnim sportskim takmičenjima;</p> <p>1.6. Sportsko posredovanje - razvoj delatnosti posredovanja ili zastupanja sportiste ili trenera u njegovom radnom odnosu, kao i delatnost posredovanja ili zastupanja sportskog kluba;</p>
---	---	---

<p>1.7. Veprimtari sportive – të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive të tilla si pjesëmarrja në garë sportive, trajnimi sportiv, edukimi sportiv, ushtrimet sportive, organizimi dhe udhëheqja e garës sportive dhe ndërmjetësimi sportiv. Veprimtari sportive konsiderohet edhe organizimi i aktivitetit shkollor sportiv jashtëkurrikular, aktivitetit akademik sportiv, aktivitetit sportiv të punëtorëve, menaxhimi i infrastrukturës sportive dhe veprimtaritë e tjera administrative ose menaxheriale në kuadër të personave juridikë si pjesë e sportit.</p> <p>2. Në kuptim të këtij Ligji, emrat në njëjërën gjini nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II SPORTI, PARIMET DHE LLOJET E SPORTEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Sporti</p> <p>1. Sporti përfshin të gjitha format e aktivitetit fizik qoftë në formë të organizuar ose jo, që synon ruajtjen ose</p>	<p>1.7. Sport activity - all forms of physical and sports activities such as participation in sports competition, sports training, sports education, sports exercises, organization and management of sports competition and sports mediation. Sports activity is also considered the organization of extracurricular school sports activity, academic sports activity, workers sports activity, management of sports infrastructure and other administrative or managerial activities within legal entities as part of sports.</p> <p>2. For the purpose of this Law, words importing the masculine gender shall also include the feminine gender and vice versa, without discrimination.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II SPORT, PRINCIPLES AND TYPES OF SPORTS</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Sport</p> <p>1. Sport includes all forms of physical activity, whether organized or not, aimed at maintaining or improving physical ability</p>	<p>1.7. Sportska delatnost– svi oblici fizičkih i sportskih aktivnosti kao što su učešće u sportskim takmičenjima, sportski trening, sportsko vaspitanje, sportske vežbe, organizacija i vođenje sportskih takmičenja i sportsko posredovanje. Sportskom delatnošću smatra se i organizovanje vannastavne školske sportske aktivnosti, akademske sportske aktivnosti, sportske aktivnosti radnika, upravljanje sportskom infrastrukturom i druge administrativne ili rukovodeće delatnosti u okviru pravnih lica u okviru sporta.</p> <p>2. U smislu ovog zakona, imena u jednom rodu podrazumevaju i imena u drugom rodu, bez diskriminacije.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II SPORT, PRINCIPI I VRSTE SPORTOVA</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Sport</p> <p>1. Sport obuhvata sve oblike fizičke aktivnosti bile organizovane ili ne, sa ciljem održavanja ili poboljšanja fizičke</p>
---	---	---

<p>përmirësimin e aftësisë fizike dhe mirëqenies mendore, krijimin e marrëdhënieve shoqërore, solidaritetit ose arritjen e rezultateve në gara të të gjitha niveleve.</p> <p>2. Sporti është veprimtari e interesit të veçantë publik në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Sporti zhvillohet në frymën e bashkëpunimit në mes të institucioneve të të gjitha niveleve, bashkëpunimit të tyre me organizatat sportive, dhe bashkëpunimit në mes të këtyre organizatave.</p> <p>4. Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë përgjegjëse për sport miraton Strategjinë Shtetërore për Sportin.</p> <p>5. Të gjitha dokumentet e institucioneve publike të nivelit qendror dhe atij lokal, si dhe dokumentet strategjike të organizatave të sportit, përfshirë planet e punës, hartohen në përputhje me Strategjinë Shtetërore të Sportit.</p>	<p>and mental well-being, creating social relationships, solidarity, or achieving results in competitions of all levels.</p> <p>2. Sport is an activity of special importance for the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Sport is practiced in the spirit of cooperation between institutions of all levels, their cooperation with sports organizations, and cooperation between these organizations.</p> <p>4. At the proposal of the respective Ministry for Sport, the government of the Republic of Kosovo shall approve the State Sport Strategy.</p> <p>5. All documents of public institutions at the central and local level as well as strategic documents of sports organizations, including annual work plans, are drawn up in accordance with the State Sport Strategy.</p>	<p>kondicije i mentalnog blagostanja, stvaranja društvenih odnosa, solidarnosti ili postizanja rezultata na takmičenjima svih nivoa.</p> <p>2. Sport je aktivnost od posebnog značaja za Republiku Kosovo.</p> <p>3. Sport se razvija u duhu saradnje institucija svih nivoa, njihove saradnje sa sportskim organizacijama i saradnje između ovih organizacija.</p> <p>4. Vlada Republike Kosovo, na osnovu predloga Ministarstva nadležnog za sport, usvaja Državnu strategiju za sport.</p> <p>5. Svi dokumenti javnih institucija na centralnom i lokalnom nivou, kao i strateški dokumenti sportskih organizacija, uključujući i planove rada, izrađuju se u skladu sa Državnom strategijom sporta.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 5 Parimet e përgjithshme të sportit</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 General principles of sports</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Opšti principi sporta</p>
<p>1. Veprimet e institucioneve publike, organizatave sportive dhe të gjithë personave të përfshirë në sport bazohen në parimet e përgjithshme si në vijim:</p> <p>1.1. Sporti për të gjithë – çdo person ka të drejtë të merret me sport, përfshirë aktivitetin fizik. Mekanizmat institucionalë dhe organizatat sportive promovojnë përfshirjen në sport;</p> <p>1.2. Ligjshmëria - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi. Çdo veprim që cenon apo mund të cenojë një të drejtë në fushën e sportit duhet të jetë i autorizuar nga ligji dhe aktet normative bazë të personit juridik që merr pjesë në veprimtari sportive;</p> <p>1.3. Qeverisja e mirë - respektimi dhe zbatimi i Kodit të Qeverisjes së Mirë të përcaktuar me këtë ligj, respektimi i rregullave përkatëse etike dhe rregullave të tjera ndërkombëtare për qeverisjen e mirë;</p> <p>1.4. Mosdiskriminimi – garantimi i pjesëmarrjes në veprimtari sportive dhe në qasje në infrastrukturë sportive në</p>	<p>1. The actions of public institutions, sports organizations and all persons involved in sports are based on the following general principles:</p> <p>1.1 Sports for all - every individual has the right to practice sports, including physical activity. Institutional mechanisms and sports organizations shall promote participation in sports.</p> <p>1.2. Legality - actions must be in accordance with the provisions of this law and other relevant legislation in force. Any action that violates or may violate a right in the field of sport must be authorized by the law and the basic normative acts of the legal entity that participates in sports activities;</p> <p>1.3. Good governance - respect and implementation of the Good Governance Code defined by this law, the relevant ethical rules of the federations and other international rules for good governance;</p> <p>1.4. Non-discrimination - guaranteeing participation in sports activities and access to sports infrastructure in</p>	<p>1. Postupanje javnih institucija, sportskih organizacija i svih lica koja se bave sportom zasniva se na sledećim općim principima:</p> <p>1.1. Sport za sve – svako ima pravo da se bavi sportom, uključujući i fizičku aktivnost. Institucionalni mehanizmi i sportske organizacije promovišu bavljenje sportom;</p> <p>1.2. Zakornitost – postupci moraju biti u skladu sa odredbama ovog zakona i drugih relevantnih zakona na snazi. Svako postupanje kojim se krši ili može povrediti neko pravo u oblasti sporta mora biti ovlašćeno zakonom i osnovnim normativnim aktima pravnog lica koje se bavi sportskom delatnošću;</p> <p>1.3. Dobro upravljanje poštovanje i primena Kodeksa dobrog upravljanja definisanog ovim zakonom, poštovanje relevantnih etičkih pravila i drugih međunarodnih pravila za dobro upravljanje;</p> <p>1.4. Nediskriminacija - garantovanje učešća u sportskim aktivnostima i pristupa sportskoj infrastrukturi u</p>

<p>përputhje me këtë ligj dhe rregullat e tjera përkatëse, si dhe ndalimi i diskriminimit në çfarëdo baze të përcaktuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi;</p> <p>1.5. Ambienti i sigurt dhe i favorshëm për të gjithë - ambientet në të cilat zhvillohen veprimtaritë sportive duhet të jenë të sigurta, ku të gjithë personat e përfshirë në veprimtari sportive trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim si dhe në përputhje me standardet që mbrojnë shëndetin e tyre. Çdo dhunë, keqpërdorim, abuzim ose dukuri tjetër negative ndalohet dhe sanksionohet me ligj;</p> <p>1.6. Transparenca - veprimet duhet të jenë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike;</p> <p>1.7. Mbrojtja e privatësisë – veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës;</p> <p>1.8. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve – ndërmarrja e të gjitha masave</p>	<p>accordance with this law and other relevant rules, as well as the prohibition of discrimination on any basis defined by the law on the protection against discrimination;</p> <p>1.5. Safe and friendly environment for everyone - the premises for the practice of sports activities must be safe, where all persons involved in sports are treated with respect, dignity and free from harassment, as well as in accordance with the standards that protect their health. Any violence, misuse, abuse or other negative phenomena are prohibited and sanctioned by law;</p> <p>1.6. Transparency - actions must be transparent and public documents accessible in accordance with the law on access to public documents;</p> <p>1.7. Privacy protection - the actions shall not violate the privacy and personal data of persons involved in sports, are protected in accordance with the relevant law;</p> <p>1.8. Protection of children and young people - undertaking taking all</p>	<p>skladu sa ovim zakonom i drugim relevantnim pravilima, kao i zabrana diskriminacije po bilo kom osnovu utvrđenom Zakonom o zaštiti od diskriminacije;</p> <p>1.5. Bezbedno i povoljan ambijent za sve - centri u kojima se odvijaju sportske aktivnosti moraju biti bezbedne, u kojima se prema svim licima koja se bave sportskim delatnostima postupa sa poštovanjem, dostojanstvom i bez uznemiravanja, kao i u skladu sa standardima koji štite njihovo zdravlje. Svako nasilje, zloupotreba, zlostavljanje ili druga negativna pojava je zabranjena i sankcionisana zakonom;</p> <p>1.6. Transparentnost – radnje moraju biti transparentne i javna dokumenta moraju biti dostupna u skladu sa relevantnim zakonom o pristupu javnim dokumentima;</p> <p>1.7. Zaštita privatnosti – radnje koje ne narušavaju privatnost i lični podaci osoba koje se bave sportom su zaštićene u skladu sa relevantnim zakonom;</p> <p>1.8. Zaštita dece i mladih - preduzimanje svih zaštitnih mera za</p>
--	---	--

<p>mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sport, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdolloj dhune ndaj tyre, keqpërdorim, ngacim ose sjellje tjetër të pahijshme;</p> <p>1.9. Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike - ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për mjedisin, natyrën dhe kafshët gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive, në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe moscenimi i sigurisë publike;</p> <p>1.10. Fair-play – sporti duhet të zhvillohet në bazë të rregullave, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Llojet e sporteve të organizuara</p> <p>1. Veprimtaritë sportive të organizuara në Kosovë sipas këtij ligji zhvillohen në çdo lloj sporti të njohur nga:</p> <p>1.1. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar si sport olimpik ose sport joolimpik;</p>	<p>protective measures for children and young people participating in sports, which include notifying the police, the guardianship body and other relevant state bodies of any kind of violence against them, abuse, harassment or other inappropriate behavior;</p> <p>1.9. Environmental protection and public security - undertaking all protective measures for the environment, nature and animals while practicing sports activities, in accordance with the relevant legislation, as well as the preservation of public security;</p> <p>1.10. Fair Play - sport is practiced on the basis of rules, respect for the opponent, prevention and avoidance of violence and unfair behavior.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Types of organized sports</p> <p>1. Sports activities organized in Kosovo according to this law take place in any type of sport recognized by:</p> <p>1.1. International Olympic Committee as Olympic sport or non-Olympic sport;</p>	<p>decu i mlade koji se bave sportom, što uključuje obaveštavanje policije, organa starateljstva i drugih nadležnih državnih organa o bilo kakvoj vrsti nasilja nad njima, zlostavljanju, uznemiravanju ili drugom nedoličnom ponašanju;</p> <p>1.9. Zaštita životne sredine i javna bezbednost - preduzimanje svih zaštitnih mera za životnu sredinu, prirode i životinja tokom razvoja sportske delatnosti, u skladu sa relevantnim zakonima, kao i nenarušavanje javne bezbednosti;</p> <p>1.10. Fer-plej – sport mora da se razvija na osnovu pravila, poštovanja protivnika, sprečavanja i izbegavanja nasilja i nepravednog ponašanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Vrste organizovanog sporta</p> <p>1. Sportske aktivnosti koje se organizuju na Kosovu u skladu sa ovim zakonom odvijaju se u bilo kojoj vrsti sporta koju priznaje:</p> <p>1.1. Međunarodni olimpijski komitet kao olimpijski sport ili neolimpijski</p>
--	--	---

<p>1.2. asociacioni përkatës i federatave sportive ndërkombëtare;</p> <p>1.3. Komiteti Paralimpik Ndërkombëtar;</p> <p>1.4. Komiteti Ndërkombëtar i Sporteve të të Shurdhërve;</p> <p>1.5. Lëvizja Ndërkombëtare e Olimpiadës Speciale;</p> <p>1.6. sportet tjera që zhvillohen në Republikën e Kosovës dhe të njohura nga Ministria përgjegjëse për sport.</p> <p>2. Veprimtaritë sportive sipas paragrafit 1 po ashtu zhvillohen në sportet elektronike.</p> <p>3. Kriter bazë për njohjen e sportit nga nënparagrafi 1.6 i paragrafit 1 të këtij neni është masiviteti i atij sporti në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Procedura e njohjes së sporteve nga nënparagrafi 1.6 i paragrafit 1 i këtij neni përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport.</p>	<p>1.2. the relevant association of international sports federations;</p> <p>1.3. International Paralympic Committee;</p> <p>1.4. International Committee of Sports for the Deaf;</p> <p>1.5. International Special Olympics Movement;</p> <p>1.6. other sports that take place in the Republic of Kosovo and recognized by the Ministry responsible for sports.</p> <p>2.Sports activities according to paragraph 1 also take place in electronic sports.</p> <p>3.The basic criteria for recognizing the sport from sub-paragraph 1.6 of paragraph 1 of this Article are the massiveness of that sport in the Republic of Kosovo.</p> <p>4.The procedure for the recognition of sports from sub-paragraph 1.6 of paragraph 1 of this Article is determined by means of a sub-legal act approved by the Minister responsible for Sports.</p>	<p>sport;</p> <p>1.2.relevantna asocijacija međunarodnih sportskih federacija;</p> <p>1.3.Međunarodni paraolimpijski komitet;</p> <p>1.4.Međunarodni komitet sporta gluvih;</p> <p>1.5.Međunarodni pokret za specijalnu olimpijadu;</p> <p>1.6.drugi sportovi koji se odvijaju u Republici Kosovo i koji su priznati od Ministarstva nadležnog za sport.</p> <p>2.Sportske delatnosti iz stava 1. se takođe odvijaju u elektronskim sportovima.</p> <p>3.Osnovni kriterijumi za priznavanje sporta iz podstava 1.6 stava 1 ovog člana su masovnost tog sporta u Republici Kosovo.</p> <p>4.Postupak za priznavanje sporta iz podstava 1.6 stava 1 ovog člana utvrđuje se podzakonskim aktom koji usvaja Ministar nadležan za sport.</p>
---	---	---

<p>5. Në rast të paqartësisë, Komiteti Olimpik i Kosovës respektivisht organizata tjetër përkatëse, ofron opinion për Ministrinë përgjegjëse për sport lidhur me klasifikimin e sportit sipas paragrafit 1, në përputhje me standardet e përcaktuara të autoritetit përgjegjës ndërkombëtar.</p> <p>6. Aktiviteti fizik, aktivitetet rekreative sportive ose lojërat tradicionale, të cilat nuk kualifikohen si sport i organizuar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, inkurajohen, promovohen dhe mund të mbështeten financiarisht nga buxheti i Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III PJESËMARRËSIT NË SPORT</p> <p style="text-align: center;">NËNKAPITULLI I PJESËMARRËSIT NË SPORT</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Pjesëmarrësit në sport</p> <p>1. Personat që marrin pjesë në veprimtari sportive janë personat fizikë dhe juridikë.</p>	<p>5. In case of ambiguity, the Kosovo Olympic Committee or other relevant organization shall provide an opinion to the Ministry responsible for sports regarding the classification of sports according to paragraph 1, in accordance with the established standards of the responsible international authority.</p> <p>6. Physical activity, recreational sports activities or traditional games, which do not qualify as organized sports according to paragraph 1 or 2 of this article, shall be encouraged, promoted and may be financially supported by the budget of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III SPORTS PARTICIPANTS</p> <p style="text-align: center;">SUBCHAPTER I SPORTS PARTICIPANTS</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Sports Participants</p> <p>1. The persons who may participate in sports activities are natural persons and legal persons.</p>	<p>5. U slučaju nejasnoća, Olimpijski komitet Kosova, odnosno druga relevantna organizacija, daje mišljenje Ministarstvu nadležnom za sport u vezi sa klasifikacijom sportova prema stavu 1, u skladu sa utvrđenim standardima nadležnog međunarodnog organa.</p> <p>6. Fizička aktivnost, rekreativne sportske aktivnosti ili tradicionalne igre, koje se ne kvalifikuju kao organizovani sport prema stavu 1. ili 2. ovog člana, podstiču se, promovišu i mogu biti finansijski podržani iz budžeta Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III UČESNICI U SPORTU</p> <p style="text-align: center;">PODPOGLAVLJE I UČESNICI U SPORTU</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Učesnici u sportu</p> <p>1. Lica koja se bave sportskim aktivnostima su fizička i pravna lica.</p>
--	--	--

<p>2.Personi fizik merr pjesë në veprimtari sportive në cilësinë e:</p> <p>2.1. sportistit;</p> <p>2.2. personit që kryen punë profesionale në sport; dhe</p> <p>2.3. agjentit sportiv.</p> <p>3.Personat juridik që marrin pjesë në veprimtari sportive janë:</p> <p>3.1.Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK);</p> <p>3.2.Komiteti Paralimpik i Kosovës (KPK);</p> <p>3.3.federatat sportive;</p> <p>3.4.klubet sportive;</p> <p>3.5.federatat shumësportive;</p> <p>3.6.shkollat e sportit;</p> <p>3.7.qendrat e fitnesit dhe qendrat sportive; dhe</p> <p>3.8.shoqatat rekreative dhe shoqatat tjera.</p>	<p>2. The natural person shall participate in sports activities in the capacity of:</p> <p>2.1. athlete;</p> <p>2.2. the person who performs professional work in sports; and;</p> <p>2.3. sports agent.</p> <p>3. The legal entities that participate in sports activities are the following:</p> <p>3.1. Kosovo Olympic Committee (KOC);</p> <p>3.2 Kosovo Paralympic Committee (KPC)</p> <p>3.3. sports federations;</p> <p>3.4. sports clubs;</p> <p>3.5. multisport federations;</p> <p>3.6. sports schools;</p> <p>3.7. fitness centers and sports centers; and</p> <p>3.8. recreational associations and other associations.</p>	<p>2. Fizičko lice se bavi sportskim aktivnostima u svojstvu:</p> <p>2.1.sportista;</p> <p>2.2.lica koja obavlja stručne poslove u sportu; i</p> <p>2.3. sportskog agenta</p> <p>3.Pravna lica koja se bave sportskim aktivnostima su:</p> <p>3.1. Olimpijski komitet Kosova (OKK);</p> <p>3.2. Paraolimpijski komitet Kosova (PKK);</p> <p>3.3. sportske federacije;</p> <p>3.4. sportski klubovi;</p> <p>3.5. višesportske federacije;</p> <p>3.6. škole sporta;</p> <p>3.7. fitnes centri i sportski centri; i</p> <p>3.8. rekreativna udruženja i druga udruženja.</p>
--	---	--

<p align="center">NËNKAPITULLI II PERSONAT FIZIKË QË MARRIN PJESË NË SPORT</p>	<p align="center">SUBCHAPTER II NATURAL PERSONS PARTICIPATING IN SPORTS</p>	<p align="center">PODPOGLAVLJE II FIZIČKA LICA KOJA SE BAVE SPORTOM</p>
<p align="center">Neni 8 Sportisti</p> <p>1.Sportisti mund të jetë profesional, amator, ose rekreativ.</p> <p>2.Sportist profesional është çdo person i cili nga trajnimi dhe pjesëmarrja në garë sportive gjeneron të hyra financiare.</p> <p>3.Sportist amator është çdo sportist tjetër që zhvillon trajnim dhe merr pjesë në garë sportive të federatave përkatëse.</p> <p>4.Sportist rekreativ është çdo person tjetër që zhvillon aktivitet të rekreacionit sportiv siç përkufizohet me këtë ligj.</p>	<p align="center">Article 8 Athlete</p> <p>1. An athlete may be professional, amateur or recreational.</p> <p>2. A professional athlete is any person who generates financial income from training and participation in sports competitions.</p> <p>3. An amateur athlete is any other athlete who carries out physical activity, training or participates in sports competitions of the respective federations or recreational competitions.</p> <p>4.Recreational athlete is any other person who practices sports recreation activity as defined by this law.</p>	<p align="center">Član 8 Sportista</p> <p>1. Sportista može biti profesionalac, amater ili rekreativac.</p> <p>2. Profesionalni sportista je svako lice koja ostvaruje finansijski prihod od treninga i učešća na sportskim takmičenjima.</p> <p>3. Sportista amater je svaki drugi sportista koji se bavi treningom i učestvuje u sportskim takmičenjima odgovarajućih federacija.</p> <p>4. Sportista rekreativac je svako drugo lice koje se bavi rekreativnim sportskim aktivnostima shodno definisano ovim zakonom.</p>
<p align="center">Neni 9 Trajneri dhe instruktori</p> <p>1.Trajner është personi i cili përgatit dhe udhëheq sportistin në garë të sportit të organizuar.</p>	<p align="center">Article 9 Coach and instructor</p> <p>1. A coach is the person who prepares and leads the athlete in organized sports competitions.</p>	<p align="center">Član 9 Trenner i instruktor</p> <p>1.Trenner je lice koja podučava i vodi sportistu u organizovanom sportskom takmičenju.</p>

<p>2.Instruktor është personi i cili udhëzon zhvillimin e sportit dhe mësimin e teknikës së një sporti apo aktivitetit fizik, por që nuk ka qëllim trajnimin ose udhëheqjen e sportistit në garë sportive.</p> <p>3.Përveç nëse me ligj të veçantë është përcaktuar ndryshe, profesionin e trajnerit mund ta ushtrojë çdo person i cili plotëson kushtet ligjore si në vijim:</p> <p>3.1. ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare;</p> <p>3.2. plotëson njërën nga këto kushte:</p> <p>3.2.1. ka diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;</p> <p>3.2.2. ka diplomë ose certifikatë të vlefshme për trajner në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose</p> <p>3.2.3. ka licensë për trajner të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.</p>	<p>2. Instructor is the person who guides the development of the sport and the teaching of the technique of a certain sport or activity, but shall not aim at training or leading the athlete in a sports competition.</p> <p>3.Coaching profession may be exercised by any person who meets the following legal conditions:</p> <p>3.1. has reached the age of eighteen (18);</p> <p>3.2. fulfills one of the following conditions:</p> <p>3.2.1. holds a relevant university degree in physical education;</p> <p>3.2.2. has a valid coaching diploma or certificate in accordance with the relevant level of the National Qualifications Framework, issued by an institution accredited by the relevant agencies in the Republic of Kosovo; or</p> <p>3.2.3 has a coaching license issued by an accredited institution outside the Republic of Kosovo.</p>	<p>2.Instruktor je lice koje usmerava razvoj sporta i podučavanje tehnike sporta ili fizičke aktivnosti, ali koje nema za cilj da trenira ili vodi sportistu na sportskom takmičenju.</p> <p>3. Osim ukoliko nije drugačije definisano posebnim zakonom, profesiju trenera može obavljati svako lice koje ispunjava sledeće zakonske uslove:</p> <p>3.1.da ima navršenih osamnaest (18) godina;</p> <p>3.2. ispunjava jedan od dole navedenih uslova:</p> <p>3.2.1. ima odgovarajuću univerzitetsku diplomu fizičkog vaspitanja;</p> <p>3.2.2. ima važeću diplomu ili sertifikat za trenera u skladu sa relevantnim nivoom Nacionalnog okvira kvalifikacija, izdat od strane institucije akreditovane od relevantnih agencija u Republici Kosovo; ili</p> <p>3.2.3. ima trenersku licencu izdatu od strane akreditovane institucije van Republike Kosovo.</p>
---	---	---

<p>3.3. nuk e ka të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sportive sipas këtij ligji.</p> <p>4. Përveç nëse me ligj të veçantë është përcaktuar ndryshe, profesionin e instruktorit mund ta ushtrojë çdo person i cili plotëson kushtet nga nënparagrafët 3.1 dhe 3.3 të këtij neni si dhe që ka:</p> <p>4.1. diplomë përkatëse universitare të edukimit fizik;</p> <p>4.2. diplomë ose certifikatë të vlefshme për instruktor në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës; ose</p> <p>4.3. licencë për instruktor të lëshuar nga një institucion i akredituar jashtë Republikës së Kosovës.</p> <p>5. Profesionin e instruktorit mund ta ushtrojë edhe personi i cili përmbush kushtet për të shërbyer si trajner sipas këtij ligji.</p> <p>6. Federatat sportive mund të përcaktojnë kërkesa shtesë për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit apo instruktorit</p>	<p>3.3.the person is not prohibited from practicing sports activities according to this law.</p> <p>4. Unless otherwise provided by a special law, the profession of instructor may be exercised by any person who meets the conditions from sub-paragraphs 3.1 and 3.3 of this article, as well as holds a:</p> <p>4.1 relevant university degree in physical education;</p> <p>4.2. valid instructor's diploma or certificate in accordance with the relevant level of the National Qualifications Framework, issued by an institution accredited by the relevant agencies in the Republic of Kosovo; or</p> <p>4.3. instructor license issued by an accredited institution outside the Republic of Kosovo.</p> <p>5.The profession of instructor may also be exercised by a person who fulfills the conditions to serve as a coach according to this Law.</p> <p>6. Sports federations may also set out additional requirements for exercising the sports coach profession within</p>	<p>3.3.da nema zabranu bavljenjem sportskim aktivnostima u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>4.Osim ukoliko nije drugačije posebnim definisano posebnim zakonom, profesiju instruktora može da obavlja svako lice koje ispunjava uslove iz stava 3.1. i 3.3. ovog člana i koje ima:</p> <p>4.1. odgovarajuću univerzitetsku diplomu fizičkog vaspitanja;</p> <p>4.2.važeću diplomu ili sertifikat za instruktora u skladu sa relevantnim nivoom Nacionalnog okvira kvalifikacija, izdata od strane institucije akreditovane od strane relevantnih agencija u Republici Kosovo; ili</p> <p>4.3.licencu instruktora izdata od strane akreditovane institucije van Republike Kosovo.</p> <p>5. Zvanje instruktor može da obavlja i lice koje ispunjava uslove za obavljanje znanja trenera u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>6. Sportske federacije mogu odrediti dodatne uslove za obavljanje delatnosti trenera ili instruktora u okviru</p>
--	--	---

<p>në kuadër të organizatave përkatëse sportive.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Personat zyrtarë që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garës sportive</p> <p>1. Personat zyrtarë që marrin pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e garës sportive janë: gjyqtari sportiv, delegati sportiv, komisioneri sportiv dhe personi tjetër që përcaktohet me akt normativ të federatës përkatëse.</p> <p>2. Kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë sportive e personave zyrtarë nga paragrafi 1 përcaktohen me akt normativ nga federata përkatëse.</p> <p>3. Në sportet e organizuara në kuadër të Komitetit Paralimpik, Federatës së Sporteve të Shurdhërve të Kosovës dhe Olimpiadës Speciale, marrin pjesë personat zyrtarë të përcaktuar sipas rregullave të këtyre organizatave, në përputhje me rregullat e zbatueshme ndërkombëtare.</p>	<p>the respective sports clubs.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Official persons participating in the organization and management of the sports competition</p> <p>1.The official persons who participate in the organization and management of the sports competition are as follows: the sports referee, the sports delegate, the sports commissioner and the other person as determined by the normative act of the relevant Federation.</p> <p>2.The terms and method of exercising the sports activity of the official persons from paragraph 1, are determined by the normative act of the relevant Federation.</p> <p>3.In the sports organized within the framework of the Paralympic Committee, Kosovo Deaf Sport Federation and the Special Olympics, shall also participate the official persons defined according to the rules of these organizations in accordance with the applicable international rules.</p>	<p>odgovarajućih sportskih organizacija.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Službena lica koja učestvuju u organizaciji i vođenju sportskog takmičenja</p> <p>1.Službena lica koja učestvuju u organizaciji i vođenju sportskog takmičenja su: sportski sudija, sportski delegat, sportski komesar i drugo lice određeno normativnim aktom nadležne federacije.</p> <p>2. Uslovi i način obavljanja sportske delatnosti službenih lica iz stava 1. utvrđuju se normativnim aktom nadležne federacije.</p> <p>3. U sportovima organizovanim u okviru Paraolimpijskog komiteta, Federacija sportova gluvih Kosova i Specijalne olimpijade učestvuju službena lica određena po pravilima ovih organizacija, u skladu sa važećim međunarodnim pravilima.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 11 Agjenti sportiv</p> <p>1. Agjenti sportiv është personi i cili zhvillon aktivitete të ndërmjetësimit sportiv dhe të përfaqësimit lidhur me transferimin e sportistit ose trajnerit nga një klub sportiv në një tjetër.</p> <p>2. Profesionin e agjentit sportiv mund ta ushtrojë çdo person i cili licencohet nga federata përkatëse sportive për të ushtruar veprimtarinë, sipas rregullave të përcaktuara nga federata, me kusht që veprimtaria e tij nuk është e ndaluar sipas këtij ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Sports agent</p> <p>1. The sports agent is the person who is involved in sports mediation and representation activities related to the transfer of the athlete or coach from one sports club to another.</p> <p>2. The profession of sports agent may be exercised by any person who is authorized by the relevant Federation in Kosovo or any other international federation to exercise the activity, provided that their activity is not prohibited as per the Article 65 or 66.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Sportski agent</p> <p>1. Sportski agent je lice koje obavlja aktivnosti sportskog posredovanja i zastupanja u vezi sa transferom sportiste ili trenera iz jednog sportskog kluba u drugi.</p> <p>2. Profesiju sportskog agenta može obavljati svako lice koje je licencirano od strane licencu nadležne sportske federacije za obavljanje delatnosti, po pravilima koje je utvrdio federacija, pod uslovom da njegova delatnost nije zabranjena ovim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Vullnetarizmi në sport</p> <p>1. Vullnetarizmi në sport është i rëndësishëm për zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në sport, përfshirë organizimin e ngjarjeve sportive.</p> <p>2. Vullnetarizmi në sport promovohet dhe nga të gjitha organizatat e sportit. Ato kujdesen për rekrutimin, trajnimin dhe marrjen e masave të përshtatshme për sigurimin e pjesëmarrjes së vullnetarëve në sport.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Volunteering in sport</p> <p>1. Volunteering in sport is important for the development of sport in general and the encouragement of participation in sport, including the organization of sporting events.</p> <p>2. Volunteering in sport shall be promoted by all sports organizations. They shall take care of recruiting, training and taking appropriate measures to ensure the participation of volunteers in sports.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Volonterizam u sportu</p> <p>1. Volonterizam u sportu važno je za razvoj sporta uopšte i podsticanje bavljenja sportom, uključujući i organizaciju sportskih događaja.</p> <p>2. Volonterizam u sportu promovišu i sve sportske organizacije. Oni se staraju o regrutovanju, obuci i preduzimanju odgovarajućih mera kako bi osigurali učešće volontera u sportu.</p>

<p>3. Personave vullnetarë të angazhuar në organizatat e sportit ju njihet kontributi i veçantë dhe përvoja e punës vullnetare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Kontrolli shëndetësor</p> <p>1. Në trajnim dhe garë sportive të sportit të organizuar mund të marrë pjesë vetëm sportisti për të cilin është e vërtetuar aftësia shëndetësore.</p> <p>2. Aftësia e sportistit vërtetohet në bazë të kontrollit shëndetësor, i cili duhet të ketë periudhë të caktuar të vlefshmërisë në përputhje me rregullat e federatës përkatëse që organizon garën sportive.</p> <p>3. Kontrolli shëndetësor sipas këtij neni bëhet nga institucionet e licencuara të nivelit sekondar apo terciar shëndetësor nga fusha e mjekësisë sportive. Federatat përkatëse kanë të drejtë të njohin kontrollin shëndetësor të sportistit të zhvilluar në një shtet tjetër.</p> <p>4. Federata përkatëse mund të përcaktoj kritere shtesë për kontroll shëndetësor të sportistit në përputhje me paragrafin 1, në bazë të veçorive të</p>	<p>3. Volunteers engaged in sports organizations shall be recognized their special contribution and volunteer work experience.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Health check</p> <p>1. Only the athlete for whom the health ability for the sport and the relevant age group has been determined can participate in the training and sports competition of the organized sport.</p> <p>2. The health ability is determined based on the health check, which must have a certain period of validity, in accordance with the rules of the relevant federation that organizes the sports competition.</p> <p>3. The health check according to this Article is carried out by licensed secondary or tertiary health institutions from the field of sports medicine. The respective federations shall have the right to recognize the health check of the athlete conducted in another country.</p> <p>4. The relevant federation may determine additional criteria for health check of the athlete in accordance with paragraph 1, based on the specifics of the relevant sport.</p>	<p>3. Volonteri licima angazhovan i u sportskim organizacijama se prizna posebni doprinos i iskustvo u volonterskom radu.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Zdravstveni pregled</p> <p>1. U organizovanim sportskim treninzima i takmičenjima može učestvovati samo sportista za koji je dokazana zdravstvena sposobnost.</p> <p>2. Sposobnost sportiste se dokazuje na osnovu zdravstvenog pregleda, koji mora imati određeni rok važenja u skladu sa pravilima odgovarajuće federacije koji organizuje sportsko takmičenje.</p> <p>3. Zdravstveni pregled iz ovog člana vrše licencirane sekundarne ili tercijarne zdravstvene institucije iz oblasti medicine sporta. Odgovarajuće federacije imaju pravo da priznaju zdravstveni pregled sportiste koji je napravljen u drugoj zemlji.</p> <p>4. Nadležne federacije mogu odrediti dodatne kriterijume za kontrolu zdravlja sportiste u skladu sa stavom 1. na osnovu specifičnosti relevantnog sporta.</p>
--	---	--

<p>sportit përkatës.</p> <p>5. Federata përkatëse mund të përcaktoj rregulla për kontrollin shëndetësor të personave të tjerë profesionalë në sport.</p> <p>6. Procedura e kontrollit shëndetësor të sportistëve përcaktohet dhe bazohet sipas protokollove klinike nga fusha e mjekësisë sportive dhe fushave tjera specialiste.</p>	<p>5. The relevant federation may determine rules for the health check of other professional persons in sport.</p> <p>6. The procedure for the health check of athletes is defined and based on clinical protocols from the field of sports medicine and other specialist fields.</p>	<p>5. Nadležne federacije mogu odrediti pravila za pregled zdravlja drugih profesionalnih lica u sportu.</p> <p>6. Postupak kontrole zdravlja sportista je definisan i zasnovan na kliničkim protokolima iz oblasti medicine sporta i drugih specijalističkih oblasti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Kontrata e sportistit profesional</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Professional athlete contract</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Ugovor profesionalnog sportiste</p>
<p>1. Kontrata e marrëdhënies së punës në mes sportistit profesional dhe klubit sportiv lidhet në formë të shkruar dhe regjistrohet në federatën përkatëse sportive në përputhje me aktet normative të federatës.</p> <p>2. Kontrata nga paragrafi 1 lidhet në kohëzgjatje të caktuar prej më së shumti pesë (5) vjet dhe nuk parasheh periudhë provuese.</p> <p>3. Kontrata nga paragrafi 1 përcakton pagën që e pranon sportisti për veprimtarinë sportive në kuadër të organizatës sportive dhe autoritetin për</p>	<p>1. The employment relationship contract between the professional athlete and the sports organization is concluded in written form and registered in the relevant sports federation in accordance with the normative acts of the federation.</p> <p>2. The contract from paragraph 1 is concluded for a fixed duration of at most five (5) years and no trial period is foreseen.</p> <p>3. The contract from paragraph 1 determines the salary that the athlete receives for the sports activity within the sports organization and the authority for</p>	<p>1. Ugovor o radnom odnosu između profesionalnog sportiste i sportske organizacije zaključuje se u pisanoj formi i registruje se u nadležnoj sportskoj federaciji u skladu sa normativnim aktima federacije.</p> <p>2. Ugovor iz stava 1. zaključuje se na određeno vreme od najviše pet (5) godina i ne obuhvata probni period.</p> <p>3. Ugovor iz stava 1. utvrđuje zaradu koju sportista prima za sportsku aktivnost u okviru sportske organizacije i organa za rešavanje sporova u vezi sa sprovođenjem</p>

<p>zgjdhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e kontratës. Paga, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës.</p>	<p>resolving disputes related to the contract execution. The salary according to this article shall not be less than the minimum wage determined by the relevant law in the Republic of Kosovo.</p>	<p>ugovora. Plata prema ovom članu ne može biti manja od minimalne zarade utvrđene relevantnim zakonom u Republici Kosovo.</p>
<p>4. Shpërblimi për arritjen e rezultateve të larta sportive të klubit ose sportistit ose të ardhurat e tjera të përcaktuara me kontratë konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti.</p>	<p>4. The reward for achieving top sports results of the sports organization or the athlete, or other income defined by contract, are considered incentives in addition to the basic salary that the athlete receives.</p>	<p>4.Priznanja za ostvareni sportski rezultat sportske organizacije ili sportiste, ili druga primanja utvrđena ugovorom, smatraju se stimulatvnm elementima povrh osnovne zarade koju sportista prima.</p>
<p>5. Sportisti nuk ka të drejtë të lidhë kontratë me më shumë se një klub sportiv në Republikën e Kosovës gjatë periudhës së njëjtë kohore.</p>	<p>5. The athlete does not have the right to enter into a contract for the same period of time with more than one sports club.</p>	<p>5.Sportista nema pravo da zaključi ugovor na isti vremenski period sa više sportskih klubova.</p>
<p>6. Kontratrat e përcaktuara në këtë nen mund të parashohin rregullim të veçantë nga legjislacioni përkatës që rregullon marrëdhënien e punës, sipas marrëveshjes mes sportistit dhe organizatës sportive, por duhet të përmbushin kriteret e caktuara me këtë nen si dhe kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.</p>	<p>6. The contracts defined in this article may provide for special regulation by the relevant legislation that regulates the employment relationship, according to the agreement between the athlete and the sports organization, but they must fulfill the criteria determined by this article and the conditions of safety and health at work defined by the legislation in force.</p>	<p>6.Ugovori definisani u ovom članu mogu predvideti posebnu formu iz relevantnog zakona kojim se uređuje radni odnos, u skladu sa sporazumom između sportiste i sportske organizacije, ali moraju ispunjavati kriterijume utvrđene ovim članom i uslove bezbednosti i zdravlja u radu definisanom važećim zakonima.</p>
<p>7. Federatat përkatëse sportive mund të përcaktojnë rregulla shitesë për kontratat e sportistëve, si dhe kërkesa për lidhjen e kontratave sportive mes klubeve dhe</p>	<p>7. Relevant sports federations may set out additional rules regarding athletes contracts, as well as requirements for the conclusion of sports contracts between</p>	<p>7. Odgovarajuće sportske federacije mogu definisati dodatna pravila za ugovore sportista, kao i uslove za zaključivanje sportskih ugovora između klubova i</p>

<p>tyre pranë organizatave, federatave, klubeve apo autoriteteve të tjera përkatëse.</p> <p>2. Shoqatat nga paragrafi 1 veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në përputhje me Ligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Kodi i Qeverisjës së Mirë</p> <p>Për të gjitha organizatat sportive zbatohet Kodi i Qeverisjës së Mirë i miratuar nga Ministri përgjegjës për Sport, pas konsultimit me organizatat e sportit.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI IV REGJISTIRMI I FEDERATAVE DHE KLUBEVE SPORTIVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Regjistrimi i federatës sportive dhe lejimi i ushtrimit të veprimtarisë</p> <p>1. Federata e sportit përkatës themelohet dhe regjistrohet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.</p>	<p>organizations, federations, clubs or other relevant authorities.</p> <p>2. Associations from paragraph 1 shall exercise their activity in accordance with the law on freedom of association in non-governmental organizations.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Code of Good Governance</p> <p>The Cod of Good Governance approved by the Minister responsible for Sports, following consultations with sports organizations, shall be applicable to all sports organizations.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER IV REGISTRATION OF FEDERATIONS AND SPORTS CLUBS</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Registration of the sports federation and permit to exercise the activity</p> <p>1. The relevant sports federation shall be established and registered in accordance with the provisions of the relevant law on freedom of association in non-governmental organizations.</p>	<p>ili drugim relevantnim organima.</p> <p>2. Udruženja iz stava 1. svoju delatnost obavljaju u skladu sa zakonom o slobodi udruživanja u nevladine organizacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Kodeks dobrog upravljanja</p> <p>Kodeks dobrog upravljanja koji je odobrio ministar nadležan za sport, nakon konsultacija sa sportskim organizacijama, primenjuje se na sve sportske organizacije.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE IV REGISTRACIJA SPORTSKIH FEDERACIJA I KLUBOVA</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Registracija sportske federacije i dozvola za obavljanje delatnosti</p> <p>1. Nadležni sportska federacija se osniva i registruje u skladu sa odredbama relevantnog zakona o slobodi udruživanja u nevladine organizacije.</p>
---	--	--

<p>2. Aplikanti për regjistrimin e federatës së sportit përkatës sipas paragrafit 1 të këtij neni, me qëllim të përdorimit të ligjshëm të emrit “Federatë” në emrin e organizatës, duhet të dëshmoj plotësimin e kriterëve bazë sportive në vijim, tek Agjencia për Sport:</p> <p>2.1. marrëveshjen e së paku pesë (5) klubeve sportive aktive në sportin e njëjtë të caktuar, ku dy (2) prej tyre janë themeluar dhe funksionojnë së paku për dy (2) vite para paraqitjes së kërkesës për themelimin dhe regjistrimin e federatës;</p> <p>2.2. posedimin e aktit normativ themelues për federatën, të harmonizuar me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet ndërkombëtare të federatës sportive të njëjtë, nëse e njëjta ekziston;</p> <p>2.3. themeluesit dhe përfaqësuesi i autorizuar të mos e kenë të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sipas dispozitave të këtij ligji; dhe</p> <p>2.4. listën me numrin e sportistëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve aktivë të saj.</p> <p>3. Agjencia për Sport, pas vlerësimit të përmbushjes së kriterëve sportive nga</p>	<p>2. For the registration of the relevant sports federation according to paragraph 1 of this article, in order to legally use the name "Federation" in the name of the organization, the applicant must prove the fulfillment of the following basic sports criteria, to the Sports Agency:</p> <p>2.1 the agreement of at least five (5) active sports clubs in the same specific sport, where two (2) of them have been established and have been operating for at least two (2) years prior to submitting the request for the establishment and registration of the federation;</p> <p>2.2. possess the founding normative act for the federation, harmonized with the provisions of this law and the international acts of the same sports federation, if the same exists;</p> <p>2.3. the founders and the authorized representative must not be prohibited from exercising the activity according to the provisions of this law, and;</p> <p>2.4. the list with the number of active athletes, coaches and referees;</p> <p>3. After evaluating the fulfillment of the sports criteria from paragraph 2 of this</p>	<p>2. Podnosilac aplikacije za registraciju odgovarajućeg sportske federacije iz stava 1. ovog člana, radi zakonitog korišćenja naziva “Federacija” u nazivu organizacije, mora da dokaže Agenciji za sport ispunjenost sledećih osnovnih sportskih kriterijuma:</p> <p>2.1. sporazum najmanje pet (5) sportskih klubova aktivnih u istom specifičnom sportu, pri čemu su dva (2) osnovana i funkcionišu najmanje dve (2) godine pre podnošenja zahteva za osnivanje i registraciju federacija;</p> <p>2.2. posedovanje osnivačkog normativnog akta za federaciju, usklađenog sa odredbama ovog zakona i međunarodnim aktima iste sportske federacije, ako ista postoji;</p> <p>2.3. da osnivačima i ovlašćenom zastupniku nije zabranjeno da obavljaju delatnost u skladu sa odredbama ovog zakona; i</p> <p>2.4. spisak sa brojem aktivnih sportista, trenera i sudija.</p> <p>3. Agencija za sport, nakon procene ispunjenosti sportskih kriterijuma iz stava</p>
---	--	--

<p>paragrafi 2 i këtij neni, nxjerr vendim për lejimin e kushtëzuar me të cilin vërteton se aplikanti për regjistrimin e Federatës së sportit përkatës i përmbush kriteret sportive për të fituar të drejtën e përdorimit të emrit “Federatë” e sportit përkatës në emrin zyrtar të organizatës.</p> <p>4. Në rast të refuzimit të lejimit të kushtëzuar, aplikanti ka të drejtë të paraqes ankesë në Ministrinë përgjegjëse për sport.</p> <p>5. Vendimi i Agjencisë për Sport nga paragrafi 3 i këtij neni, bëhet pjesë e dokumentacionit për regjistrim të federatës në ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve.</p> <p>6. Lejimi për ushtrimin e veprimtarisë bëhet i vlefshëm nga momenti kur Federata regjistrohet në ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve.</p> <p>7. Brenda periudhës një (1) vjeç lejimi i ushtrimit të veprimtarisë sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji, Federata duhet të dëshmoj tek Agjencia plotësimin e kushteve nga Neni 19.</p> <p>8. Procedura e lejimit të ushtrimit të</p>	<p>article, the Sports Agency shall issue a decision on the conditional permit by which it certifies that the applicant, regarding the registration of the relevant sports Federation, fulfills the sports criteria to acquire the right to use the name "Federation" ” of the respective sport in the official name of the organization.</p> <p>4. In case of rejection of the conditional permit, the applicant has the right to submit a complaint to the Ministry responsible for sports.</p> <p>5. The decision of the Sports Agency from paragraph 3 of this article shall become part of the documentation for registration of the federation in the ministry responsible for registration of NGOs.</p> <p>6. The permit to exercise the activity becomes valid from the moment when the Federation is registered with the ministry responsible for the registration of NGOs.</p> <p>7. Within a (1) one-year period, the Federation must prove to the Agency the fulfillment of the conditions from Article 19 regarding the permit to exercise the activity according to the relevant provisions of this law.</p> <p>8. The procedure for permitting the</p>	<p>2. ovog člana, donosi rešenje o uslovnoj dozvoli kojim potvrđuje da podnosilac aplikacije za registraciju federacije odgovarajućeg sporta ispunjava sportske kriterijume za sticanje pravo korišćenja naziva “Federacija” dotičnog sporta u zvaničnom nazivu organizacije.</p> <p>4. U slučaju odbijanja uslovne dozvole, podnosilac aplikacije ima pravo da podnese prigovor Ministarstvu nadležnom za sport.</p> <p>5. Odluka Agencije za sport iz stava 3. ovog člana postaje sastavni deo dokumentacije za registraciju federacije u ministarstvu nadležnom za registraciju nevladinih organizacija.</p> <p>6. Odobrenje za obavljanje delatnosti postaje važeća od momenta registracije Federacije kod ministarstva nadležnog za registraciju nevladinih organizacija.</p> <p>7. U roku od jedne (1) godine od dobijanja dozvole za obavljanje delatnosti u skladu sa relevantnim odredbama ovog zakona, Federacija mora Agenciji dokazati ispunjenost uslova iz člana 19.</p> <p>8. Postupak za omogućavanje obavljanja</p>
---	---	--

<p>veprimtarisë së federatës sportive nga Agjencia për Sport, përfshirë procedurën e pezullimit dhe revokimit të lejimit, si dhe çështjet e tjera me rëndësi, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë përgjegjëse për Sport.</p> <p>9. Ky nen zbatohet përshtatshëmrisht edhe për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Federatën e Sportit Universitar të Kosovës dhe shoqatat sportive të punëtorëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 30 Regjistrimi i klubeve sportive</p> <p>1. Klubi sportiv fillimisht regjistrohet në Ministrinë përgjegjëse për punë të brendshme në rast se vepron si organizatë joqeveritare apo në Ministrinë përgjegjëse të tregtisë në rast se vepron si shoqëri tregtare, në përputhje me dispozitat e ligjeve përkatëse.</p> <p>2. Për të marrë pjesë në garë sportive të organizuar klubi sportiv regjistrohet në federatën sportive përkatëse.</p> <p>3. Kushtet për regjistrim të klubit në federatë sportive janë:</p>	<p>exercise of the activity of the sports federation by the Sports Agency, including the procedure for suspending and revoking the permit, as well as other important issues, shall be determined by means of a sub-legal act issued by the Ministry responsible for Sports.</p> <p>9. This article shall also apply appropriately to the Kosovo School Sports Federation, Kosovo University Sports Federation and workers sports associations.</p> <p style="text-align: center;">Article 30 Registration of sports clubs</p> <p>1. The sports club is first registered with the responsible Ministry for internal affairs in case it acts as a non-governmental organization or with the responsible Ministry of Trade in case it acts as a commercial company, in accordance with the provisions of the relevant laws.</p> <p>2. To participate in organized sports competition, the sports club registers with the respective sports federation.</p> <p>3. The conditions for registration of the club in the sports federation are:</p>	<p>delatnosti sportske federacije od strane Agencije za sport, uključujući postupak za suspenziju i oduzimanje dozvole, kao i druga bitna pitanja, utvrđuju se podzakonskim aktom Ministarstva nadležnog za sport.</p> <p>9. Ovaj član se celishodno primenjuje na Federaciju školskog sporta Kosova, Federaciju univerzitetskog sporta Kosova i sportska udruženja radnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 30 Registracija sportskih klubova</p> <p>1. Sportski klub prvenstveno se registruje kod nadležnog Ministarstva unutrašnjih poslova ako deluje kao nevladina organizacija ili kod nadležnog Ministarstva trgovine u slučaju da deluje kao privredno društvo, u skladu sa odredbama relevantnih zakona.</p> <p>2. Za učešće u organizovanom sportskom takmičenju, sportski klub se registruje kod odgovarajućeg sportske federacije.</p> <p>3. Uslovi za registraciju kluba u sportskoj federaciji su:</p>
---	--	---

<p>3.1. statuti dhe aktet e tjera normative për themelimin e klubit sportiv të miratuara;</p> <p>3.2. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas këtij ligji;</p> <p>3.3. vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e klubit ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;</p> <p>3.4. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;</p> <p>3.5. lista e sportistëve që janë pjesë e klubit dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Nenin 9.</p> <p>4. Federata përkatëse sportive miraton aktin normativ përkatës për regjistrimin e klubeve sportive në përputhje me këtë nen, ku mund të përcaktojë kushte shtesë nga ato të vendosura në paragrafin 3 të këtij neni. Federata përmes aktit normativ rregullon</p>	<p>3.1. statute and other normative acts for the establishment of the approved sports club;</p> <p>3.2. the established governing structures and the persons engaged in the governing bodies should not be prevented from exercising this activity according to this law;</p> <p>3.3. the decision of the municipality, proving the headquarters of the club where it exercises its basic sports activity;</p> <p>3.4. possession of the optimal infrastructure for the exercise of the club sports activity, which is verified by the municipality or other manager of the relevant infrastructure;</p> <p>3.5. the list of athletes who are part of the club and the engaged coach who meets the conditions set forth in Article 9.</p> <p>4. The relevant sports federation shall approve the relevant normative act for the registration of sports clubs in accordance with this article, where it may also lay down additional conditions from those established in paragraph 3 of this article. Through the normative act, the Federation</p>	<p>3.1. statut i drugi normativni akti odobreni za osnivanje sportskog kluba;</p> <p>3.2. da osnovanim rukovodećim strukturama i licima angažovana u organima upravljanja nije zabranjeno da obavljaju ove delatnosti u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>3.3. rešenje opštine kojim se dokazuje sedište kluba u kome obavlja osnovnu sportsku delatnost;</p> <p>3.4. posedovanje optimalne infrastrukture za obavljanje sportske delatnosti kluba, koju overava opština ili drugi upravnik odgovarajuće infrastrukture;</p> <p>3.5. spisak sportista koji su u sastavu kluba i angažovanog trenera koji ispunjava uslove navedene u članu 9.</p> <p>4. Nadležna sportska federacija usvaja odgovarajući normativni akt za registraciju sportskih klubova u skladu sa ovim članom, pri čemu može odrediti dodatne uslove iz stava 3. ovog člana. Kroz normativni akt, Federacija reguliše i suspenziju i oduzimanje registracije.</p>
---	---	--

<p>edhe pezullimin dhe revokimin e regjistrimit të klubeve.</p> <p>5. Klubi sportiv mban së paku një herë në vit mbledhjen e Kuvendit në të cilën shqyrtohet raporti financiar si dhe plani i punës për vitin aktual si dhe për çdo ndryshim në strukturën e klubit njoftohet federata përkatëse.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Pezullimi dhe revokimi i lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së federatës së sportit përkatës</p> <p>1. Pezullimi i lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së federatës së sportit përkatës bëhet kur:</p> <p>1.1. lejimi për ushtrimin e veprimtarisë është siguruar në bazë të dokumenteve falsifikuara apo informacionit tjetër jo të vërtetë, duke e bërë Federatën të mos përmbush kriteret për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë;</p> <p>1.2. themeluesit dhe përfaqësuesit e strukturave qeverisëse ushtrojnë veprimtari për qëllime tjera nga ato që janë përcaktuar në aktin e themelimit;</p>	<p>shall also regulate the suspension and revocation of clubs registration.</p> <p>5. The sports club shall hold the Assembly meeting at least once a year, where the financial report and the work plan for the current year are reviewed, and the Federation is notified of any changes in the structure of the club.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Suspension and revocation of the permit to exercise the activity of the relevant sports federation</p> <p>1. The suspension of the permit to exercise the activity of the relevant sports federation is given when:</p> <p>1.1. the permit to exercise the activity was obtained on the basis of falsified documents or other untrue information, causing the Federation not to fulfill the criteria for the permit to exercise the activity;</p> <p>1.2. founders and representatives of governing structures exercise activities for purposes other than those defined in the act of establishment;</p>	<p>5. Sportski klub najmanje jednom godišnje održava sednicu Skupštine na kojoj se razmatra finansijski izveštaj i plan rada za tekuću godinu, kao i za svaku promenu u strukturi kluba treba obavestiti Federaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Suspenzija i oduzimanje dozvole za obavljanje delatnosti odgovarajuće sportske federacije</p> <p>1. Suspenzija dozvole za obavljanje delatnosti odgovarajućeg sportske federacije vrši se kada:</p> <p>1.1. odobrenje za obavljanje delatnosti dobijena je na osnovu falsifikovanih dokumenata ili drugih lažnih podataka, zbog čega Federacija ne ispunjava kriterijume za odobrenje za obavljanje delatnosti;</p> <p>1.2. osnivači i predstavnici rukovodećih struktura obavljaju delatnost u druge svrhe osim onih definisanih aktom o osnivanju;</p>
---	---	--

<p>1.3.dështon vazhdimisht të raportojë për fondet e pranuar publike, dhe dështon vazhdimisht në procesin e nënshtrimit të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të auditimit të menaxhimit të parasë publike; ose</p> <p>1.4.shkelen në vazhdimësi dispozitat e këtij ligji dhe si rezultat i shkeljeve të vazhdueshme pamundësohet zhvillimi normal i sportit të caktuar.</p> <p>2.Pezullimi ka karakter të përkohshëm, ku federatës së sportit përkatës i ofrohet mundësia për të përmirësuar shkeljen e konstatuar nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar.</p> <p>3.Në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve nga Agjencia e Sportit, federatës së sportit përkatës i revokohet lejimi i ushtrimit të veprimtarisë.</p> <p>4.Agjencia e Sportit është përgjegjëse për pezullimin dhe revokimin e lejimit të ushtrimit të veprimtarisë të federatës sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit të Inspektoratit për Sport.</p> <p>5.Kundër vendimit të Agjencisë nga paragrafi 4 i këtij neni, pala e pakënaqur</p>	<p>1.3. consistently fails to report on public funds received, and consistently fails in the process of undergoing internal control and external audit of the management of public money; or</p> <p>1.4. the provisions of this law are continuously violated and as a result of continuous violations, the normal practice of the given sport becomes impossible.</p> <p>2. The suspension has a temporary character, where the relevant sports federation is offered the opportunity to correct the violation established by paragraph 1 of this article, within the specified period.</p> <p>3. In case of failure to act according to the instructions from the Sports Agency, the permit to exercise the activity shall be revoked for the relevant sports federation.</p> <p>4. The Sports Agency is responsible for the suspension and revocation of the permit to exercise the activity of the federation according to the official duty or on the basis of the proposal of the Sports Inspectorate.</p> <p>5. The dissatisfied party can submit a complaint to the Ministry responsible for</p>	<p>1.3.kontinuirano ne izveštava o primljenim javnim sredstvima i kontinuirano ne podvrgava procesu interne kontrole i eksterne revizije upravljanja javnim novcem; ili</p> <p>1.4.kontinuirano se krše odredbe ovog zakona, a usled kontinuiranih prekršaja normalan razvoj datog sporta postaje nemoguć.</p> <p>2.Suspenzija ima privremeni karakter, pri čemu se odgovarajućeg sportskoj federaciji pruža mogućnost da u određenom roku popravi prekršaj utvrđen stavom 1. ovog člana.</p> <p>3.U slučaju nepostupanja po uputstvima Agencije za sport, odgovarajućoj sportskoj federaciji se oduzima dozvola za obavljanje delatnosti.</p> <p>4.Agencija za sport nadležna je za suspenziju i oduzimanje dozvole za obavljanje delatnosti federacije po službenoj dužnosti ili na osnovu predloga Sportske inspekcije.</p> <p>5.Protiv rešenja Agencije iz stava 4. ovog člana, nezadovoljna strana može podneti</p>
--	--	--

<p>mund të parashtroj ankesë në Ministrinë përgjegjëse për Sport.</p> <p>6.Ky nen zbatohet përshtatshëmrisht edhe për Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës, Federatën e Sportit Universitar të Kosovës dhe shoqatat sportive të punëtorëve.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI V ZHVILLIMI I SPORTIT GARUES</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Garat sportive</p> <p>1. Gara sportive është një garë e organizuar e klubeve sportive ose e sportistëve individualë që organizohet dhe drejtohet nga një person juridik i autorizuar për organizimin dhe menaxhimin e një gare sportive.</p> <p>2. Gara sportive e organizuar nga federatat sportive ose anëtarët e tyre zhvillohet në përputhje me aktet përkatëse të federatës sportive që përcaktojnë elementet bazë të sistemit të garave në kategori të ndryshme të moshave dhe në rang garash qoftë në atë të nivelit lokal, rajonal apo shtetëror.</p>	<p>Sport against the decision of the Agency from paragraph 4 of this article.</p> <p>6. This article shall apply accordingly to the Kosovo School Sports Federation, the Kosovo University Sports Federation and workers sports associations.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER V ORGANIZATION OF COMPETITIVE SPORTS</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Sports competitions</p> <p>1. A sports competition is an organized competition of sports clubs or individual athletes that is organized and managed by a legal entity authorized for the organization and management of a sports competition.</p> <p>2.The sports competitions organized by the sports federations or their members take place in accordance with the relevant acts of the sports federation that define the basic elements of the competition system in different age categories and competition levels, either at the local or state level.</p>	<p>žalbu Ministarstvu nadležnom za sport.</p> <p>6.Ovaj član se celishodno primenjuje na Federaciju školskog sporta Kosova, Federaciju univerzitetskog sporta Kosova i sportska udruženja radnika.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE V RAZVOJ TAKMIČARSKOG SPORTA</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Sportska takmičenja</p> <p>1. Sportsko takmičenje je organizovano takmičenje sportskih klubova ili sportista pojedinaca koje organizuje i vodi pravno lice ovlašćeno za organizovanje i vođenje sportskog takmičenja.</p> <p>2.Sportska takmičenja u organizaciji sportskih federacija ili njihovih članova odvijaju se u skladu sa relevantnim aktima sportske federacije koji definišu osnovne elemente sistema takmičenja u različitim starosnim kategorijama i rangovima takmičenja, bilo na lokalnom, regionalnom ili državnom nivou.</p>
---	--	---

3. Organizatori i drejtpërdrejtë i garës sportive është i detyruar të ofrojë siguri për pjesëmarrësit në garë dhe publikun, si dhe ndihmë mjekësore përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 33
Garat sportive ndërkombëtare

1. Gara sportive ndërkombëtare në Republikën e Kosovës organizohet në përputhje me këtë ligj si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga federata ndërkombëtare e sportit përkatës.

2. Propozimi i kandidaturës për organizimin e garës ndërkombëtare shumëdisiplinare bëhet nga KOK, kurse për kampionatet dhe kupat botërore dhe evropiane në sporte të caktuara bëhet nga federata përkatëse e sportit të caktuar.

3. KOK, Olimpiada Speciale ose FSSHK propozojnë kandidaturën për mbajtjen e garës ndërkombëtare shumëdisiplinare përkatëse.

4. Federata e Sportit Shkollor ose Federata e Sportit Universitar propozojnë kandidaturën për mbajtjen e garës

3. The direct organizer of the sports competition is obliged to provide security for the participants in the competition and the public, as well as relevant medical assistance in accordance with the legislation in force.

Article 33
International sports competitions

1. International sports competitions in Kosovo are organized in accordance with this Law and the conditions, as well as the criteria determined by the relevant international sports federation.

2. The candidature proposal for the organization of the international multi-disciplinary competition is made by the KOC, while for the world and European championships and cups in specific sports by the respective federations of the respective sport.

3. KOC, SO or the KDSF shall propose the candidature for organizing the relevant international multi-discipline competition.

4. The School Sports Federation or the University Sports Federation shall propose the candidature for organizing the

3. Neposredni organizator sportskog takmičenja dužan je da osigurava bezbednost za učesnike takmičenja i publiku, kao i odgovarajuću medicinsku pomoć u skladu sa važećim zakonima.

Član 33
Međunarodna sportska takmičenja

1. Međunarodna sportska takmičenja u Republici Kosovo organizuju se u skladu sa ovim Zakonom kao i uslovima i kriterijumima koje utvrđuje relevantna međunarodna sportska federacija.

2. Predlog kandidature za organizaciju međunarodnog multidisciplinarnog takmičenja realizuje OKK, a za svetska i evropska prvenstva i kupove u pojedinim sportovima realizuje odgovarajuća federacija određenog sporta.

3. OKK, Specijalna olimpijada ili FSGK predlažu kandidaturu za održavanje odgovarajućeg međunarodnog multidisciplinarnog takmičenja.

4. Federacija školskog sporta ili Federacija univerzitetskog sporta predlažu kandidaturu za održavanje međunarodnog

<p>ndërkombëtare shkollore gjegjësisht universitare.</p> <p>5. Iniciativa për kandidim bëhet në koordinim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera përkatëse për çështjet që kanë të bëjnë me financimin, infrastrukturën, sigurinë dhe elemente të tjera të rëndësishme për organizimin e garës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 34 Pjesëmarrja e shtetasve të huaj në gara sportive dhe natyralizimi i tyre</p> <p>1. Shtetasi i huaj mund të marrë pjesë në garë sportive në Republikën e Kosovës apo të regjistrohet si lojtar i huaj në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga federata vendore përkatëse sportive dhe në përputhje me ligjin përkatës që rregullon qëndrimin dhe punën e të huajve në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Me kërkesë të federatës përkatëse dhe sipas rekomandimit të KOK, ose KPK për parasportistët, Presidentit të Republikës së Kosovës mund t'i propozohet që një sportisti që është shtetas i huaj t'i jepet shtetësia e Kosovës, me</p>	<p>international school respectively university competition.</p> <p>5. The initiative regarding the candidature shall be done in close coordination with the Government of the Republic of Kosovo and other relevant institutions for issues related to financing, infrastructure, security and other important elements for the organization of the competition.</p> <p style="text-align: center;">Article 34 Participation of foreign citizens in sports competitions and their naturalization</p> <p>1. A foreign citizen may participate in a sports competition in the Republic of Kosovo or register as a foreign player in accordance with the conditions and criteria determined by the relevant local sports federation and the relevant law that regulates the residence and work permit of foreigners in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. At the request of the relevant federation, and following the opinion of the KOC, or KPC for the para-athletes, it may be proposed to the President of the Republic of Kosovo that an athlete who is a foreign citizen be granted the citizenship of</p>	<p>školskog ili univerzitetskog takmičenja.</p> <p>5. Inicijativa za kandidaturu se vrši u bliskoj saradnji sa Vladom Republike Kosovo i drugim relevantnim institucijama za pitanja koja se odnose na finansiranje, infrastrukturu, bezbednost i druge važne elemente za organizaciju takmičenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 34 Učešće stranih državljana na sportskim takmičenjima i njihova naturalizacija</p> <p>1. Strani državljanin može učestvovati na sportskom takmičenju u Republici Kosovo ili se registrovati kao strani igrač u skladu sa uslovima i kriterijumima koje utvrđuje nadležna domaća sportska federacija i u skladu sa relevantnim zakonom koji reguliše boravak i rad stranaca u Republike Kosovo.</p> <p>2. Na zahtev odgovarajućeg federacije i prema preporuci OKK-a, odnosno PKK-a za parasportiste, može se predložiti predsedniku Republike Kosovo da sportisti koji je strani državljanin dobije državljanstvo Kosova kako bi isti postane</p>
---	--	---

qëllim që i njëjti të bëhet pjesë e përfaqësueses shtetërore të sportit përkatës.

KAPITULLI VI MEKANIZMAT INSTITUCIONALË

Neni 35 Ministria përgjegjëse për Sport

1. Ministria përgjegjëse për Sport është institucioni kryesor i Qeverisë së Kosovës në fushën e sportit dhe ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1.1. përgatit politikat publike për sportin dhe aktivitetin fizik;

1.2. propozon dhe harton aktet ligjore, harton dhe miraton aktet nënligjore dhe përcakton standardet në fushën e sportit në përputhje me këtë ligj;

1.3. zhvillon infrastrukturën e sportit;

1.4. bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat e sportit për zhvillimin e sportit në Republikën e Kosovës, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre;

Kosovo in order for them to become part of the national team of the respective sport.

CHAPTER VI INSTITUTIONAL MECHANISMS

Article 35 Ministry responsible for Sport

1. The Ministry responsible for Sport is the main institution of the Government of Kosovo in the field of sports, and has the following duties and responsibilities:

1.1. prepares public policies for sport and physical activity;

1.2. proposes and drafts legal acts, drafts and approves sub-legal acts and defines standards in the field of sports in accordance with this law;

1.3. develops sports infrastructure;

1.4. cooperates with all sports institutions and organizations for the development of sports in the Republic of Kosovo, respecting the independence of their operation;

deo reprezentacije dotičnog sporta.

POGLAVLJE VI INSTITUCIONALNI MEHANIZMI

Član 35 Ministarstvo nadležno za sport

1. Ministarstvo nadležno za sport je glavna institucija Vlade Kosova u oblasti sporta i ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

1.1. priprema javne politike za sport i fizičku aktivnost;

1.2. predlaže i izrađuje zakonske akte, izrađuje i usvaja podzakonske akte i definiše standarde u oblasti sporta u skladu sa ovim zakonom;

1.3. razvija sportsku infrastrukturu;

1.4. saraduje sa svim sportskim institucijama i organizacijama za razvoj sporta u Republici Kosovo, poštujući nezavisnost njihovog delovanja;

<p>1.5.zhvillon aspektet e diplomacisë sportive në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Punë të Jashtme;</p> <p>1.6.kryen detyra të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Agjencia e Sportit</p> <p>1. Agjencia e Sportit është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport që ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:</p> <p>1.1. promovon dhe zhvillon sportin në bashkëpunim me organizatat e sportit, federatat sportive, federatat dhe shoqatat shumësportive dhe pjesëmarrësit tjerë në sport;</p> <p>1.2. zhvillon procedurën administrative të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë të federatave sportive, dhe organizatave tjera në përputhje me dispozitat e këtij ligji;</p> <p>1.3. ofron mbështetje financiare për sportin e organizuar dhe aktivitetin fizik;</p>	<p>1.5. develops aspects of sports diplomacy in cooperation with the Ministry of Foreign Affairs;</p> <p>1.6. performs other tasks assigned to the ministry by the relevant legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Sports Agency</p> <p>1. The Sports Agency is an executive agency within the Ministry responsible for Sport with the following duties and responsibilities:</p> <p>1.1. promotes and develops sport in cooperation with sports organizations, sports federations, multi-sport federations and associations and other sports participants;</p> <p>1.2. develops the administrative procedure for permitting sports federations and other organizations to exercise their activities in accordance with the provisions of this law;</p> <p>1.3. provides financial support for organized sports and physical activity;</p>	<p>1.5. razvija aspekte sportske diplomatije u saradnji sa Ministarstvom nadležnim za spoljne poslove;</p> <p>1.6. obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Agencija za sport</p> <p>1. Agencija za sport je izvršna agencija u okviru Ministarstva nadležnog za sport koja ima sledeće dužnosti i odgovornosti:</p> <p>1.1. promoviše i razvija sport u saradnji sa sportskim organizacijama, sportskim federacijama, višesportskim federacijama i udruženjima i drugim sportskim takmičarima;</p> <p>1.2. razvija administrativni postupak za omogućavanje sportskim federacijama i drugim organizacijama da obavljaju svoju delatnost u skladu sa odredbama ovog zakona;</p> <p>1.3. pruža finansijsku podršku za organizovani sport i fizičku aktivnost;</p>
--	---	--

<p>1.4. monitoron rregullisht zbatimin e Strategjisë së Sportit si dhe raporton në Ministrinë përgjegjëse për Sport dhe autoritetet e tjera përkatëse për progresin e arritur;</p> <p>1.5. promovon, mbështet, zbaton dhe koordinon zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse;</p> <p>1.6. menaxhon Regjistrin Shtetëror të Sportit;</p> <p>1.7. mbledh, analizon dhe publikon rregullisht të dhënat për fushën e sportit;</p> <p>1.8. bën regjistrimin e federatave sportive;</p> <p>1.9. bashkëpunon me të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, organizatat sportive dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile, të cilat kanë fushëveprim sportin;</p> <p>1.10. propozon miratimin e kodit të qeverisjes së mirë;</p> <p>1.11. nxjerr protokollin për pjesëmarrje ndërkombëtare në garat sportive, në bashkëpunim me organizatat sportive;</p>	<p>1.4. regularly monitors the implementation of the Sports Strategy and reports to the Ministry responsible for Sports and other relevant authorities on the progress achieved;</p> <p>1.5. promotes, supports, implements and coordinates the implementation of the provisions of this law and relevant sub-legal acts;</p> <p>1.6. manages the State Sports Registry;</p> <p>1.7. regularly collects, analyzes and publishes data on the field of sports;</p> <p>1.8. registers sports federations;</p> <p>1.9. cooperates with all central and local level institutions, sports organizations and other civil society organizations, with sports in their scope of activities;</p> <p>1.10. proposes the adoption of the good governance code;</p> <p>1.11. issues the protocol for international participation in sports competitions, in cooperation with</p>	<p>1.4. redovno prati sprovođenje Strategije sporta i izveštava Ministarstvo nadležno za sport i druge nadležne organe o postignutom napretku;</p> <p>1.5. promovise, podržava, sprovodi i koordinira sprovođenje odredaba ovog zakona i relevantnih podzakonskih akata;</p> <p>1.6. vodi Državni sportski registar;</p> <p>1.7. redovno prikuplja, analizira i objavljuje podatke za oblast sporta;</p> <p>1.8. registruje sportske federacije;</p> <p>1.9. saraduje sa svim institucijama na centralnom i lokalnom nivou, sportskim organizacijama i drugim organizacijama civilnog društva, kojima sport je domen delovanja;</p> <p>1.10. predlaže donošenje kodeksa dobrog upravljanja;</p> <p>1.11. donosi protokol za međunarodno učešće na sportskim takmičenjima, u saradnji sa sportskim organizacijama;</p>
---	---	---

<p>1.12.nxjerr udhëzime për unifikimin e metodologjisë së zhvillimit të politikave për organizatat e sportit, federatat dhe shoqatat shumësportive, federatat sportive dhe anëtarëve të dhe tyre; dhe</p> <p>1.13.kryen detyra të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Agjencia e Sportit udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse në fuqi për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Organizimi i brendshëm i Agjencisë së Sportit rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përgjegjës për Sport dhe të miratuar nga Kryeministri.</p> <p>4. Mjetet financiare për veprimtarinë e Agjencisë sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës. Për realizimin e mandatit të promovimit dhe zhvillimit të sportit Agjencia mund të pranojë fonde të tjera, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë vendimmarrëse dhe financiare të saj. Fondet e pranuar</p>	<p>sports organizations;</p> <p>1.12. issues guidelines for the unification of policy development methodology for sports organizations, multi-sport federations and associations, sports federations and their members; and</p> <p>1.13. perform other duties in accordance with the legislation in force.</p> <p>2. The Sports Agency is led by the Executive Director. The appointment, dismissal, functions and responsibilities of the Executive Director are regulated by the relevant provisions in force for public officials in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The organization, structuring and operation of the Sports Agency is regulated by a sub-legal act proposed by the Ministry responsible for sports and approved by the Prime Minister.</p> <p>4. Funds for the Agency's activity are provided from the budget of the Republic of Kosovo. For reasons of fulfilling the mandate related to the promotion and development of sport, the Agency may accept other funds which in no way should affect its decision-making and financial independence. The received funds are</p>	<p>1.12. izdaju smernice za ujedinjenje metodologije razvoja politike za sportske organizacije, višesportske federacije i udruženja, sportske federacije i njihove članove; i;</p> <p>1.13. obavlja i druge zadatke u skladu sa važećim zakonima.</p> <p>2.Agencijom za sport rukovodi Izvršni direktor. Imenovanje, razrešenje, funkcije i odgovornosti Izvršnog direktora regulisani su relevantnim odredbama za javne službenike na snazi u Republici Kosovo.</p> <p>3. Unutrašnja organizacija Agencije za sport uređuje se podzakonskim aktom koji predlaže ministar nadležan za sport, a odobrava premijer Vlade.</p> <p>4. Finansijska sredstva za rad Agencije obezbeđuju se iz budžeta Republike Kosovo. Za ostvarivanje mandata promocije i razvoja sporta Agencija može primiti i druga sredstva koja ni na koji način ne bi trebalo da utiču na njeno odlučivanje i finansijsku nezavisnost. Priljena sredstva se objavljuju na</p>
--	--	---

<p>bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Inspektorati i Sportit</p> <p>1. Inspektorati i Sportit është agjenci ekzekutive, e cila themelohet dhe vepron në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport.</p> <p>2. Inspektorati i Sportit udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv. Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv rregullohen me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi për zyrtarët publikë në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Organizimi i brendshëm i Inspektoratit të Sportit rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përgjegjës për Sport dhe të miratuar nga Kryeministri.</p> <p>4. Mjetet financiare për veprimtarinë e Inspektoratit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.</p>	<p>made public on the official website of the Agency.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Sports Inspectorate</p> <p>1. The Sports Inspectorate is an executive agency which is established and operates within the Ministry responsible for Sports.</p> <p>2. The Sports Inspectorate is led by the Executive Director. The appointment, dismissal, functions and responsibilities of the Executive Director are regulated by the relevant provisions of the legislation in force for public officials in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The internal organization of the Sports Inspectorate is regulated by means of a sub-legal act proposed by the Minister responsible for Sports and approved by the Prime Minister.</p> <p>4. Funds for the activities of the Inspectorate are provided from the budget of the Republic of Kosovo.</p>	<p>zvaničnoj internet stranici Agencije.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Inspektorat za sport</p> <p>1. Inspektorat za sport je izvršna agencija koji se osniva i deluje u okviru Ministarstva nadležnog za sport.</p> <p>2. Inspektorat za sport vodi Izvršni direktor. Imenovanje, razrešenje, funkcije i odgovornosti Izvršnog direktora regulisani su relevantnim odredbama zakona na snazi za javne službenike u Republici Kosovo, izvršna agencija, koja je osnovana i deluje u okviru Ministarstva nadležnog za sport.</p> <p>3. Unutrašnja organizacija Inspektorata za sport uređuje se podzakonskim aktom koji predlaže ministar nadležan za sport, a odobrava premijer Vlade.</p> <p>4. Finansijska sredstva za rad Inspektorata obezbeđuju se iz budžeta Republike Kosovo.</p>
--	---	---

<p align="center">Neni 38 Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Inspektoratit të Sportit</p>	<p align="center">Article 38 The main duties and responsibilities of the Sports Inspectorate</p>	<p align="center">Član 38 Glavne dužnosti i odgovornosti Inspektorata za Sport</p>
<p>1. Inspektorati i Sportit është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve për të gjithë pjesëmarrësit në sport, përfshirë njësitë përkatëse të mekanizmave institucionalë.</p> <p>2. Inspektorati i Sportit kryen inspektimet që kanë të bëjnë me:</p> <p>2.1.përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj dhe legjislacionit në fuqi i ndërlidhur me sportin;</p> <p>2.2.infrastrukturën sportive;</p> <p>2.3.mirëmbajtjen dhe zbatimin e Regjistrit Shtetëror të Sportit;</p> <p>2.4. harmonizimin e akteve normative të organizatave të sportit me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;</p> <p>2.5. pengesat për personat të cilëve i ndalohet pjesëmarrja në sport sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji;</p>	<p>1. The Sports Inspectorate is responsible for conducting inspections for all participants in sports, including relevant units of institutional mechanisms.</p> <p>2. The Sports Inspectorate shall carry out inspections related to:</p> <p>2.1. the fulfillment of the obligations defined by this law and the legislation in force related to sports;</p> <p>2.2. sports infrastructure;</p> <p>2.3. maintenance and implementation of the State Sports Registry;</p> <p>2.4. harmonizing the normative acts of sports organizations with the provisions of this law and relevant legislation in force;</p> <p>2.5. restrictions for persons who are prohibited from participating in sports according to the relevant provisions of this law;</p>	<p>1. Inspektorat za sport je nadležno za sprovođenje inspeksijskog nadzora za sve učesnike u sportu, uključujući i relevantne jedinice institucionalnih mehanizama..</p> <p>2. Inspektorat za sport vrši inspeksijski nadzor koje se donose na:</p> <p>2.1.ispunjavanje obaveza utvrđenih ovim zakonom i važećim zakonima koji se odnose na sport;</p> <p>2.2.sportsku infrastrukturu;</p> <p>2.3.održavanje i sprovođenje Državnog sportskog registra;</p> <p>2.4.usklađivanje normativnih akata sportskih organizacija sa odredbama ovog zakona i relevantnih zakona na snazi;</p> <p>2.5.prepreke za lica kojima je zabranjeno bavljenje sportom prema relevantnim odredbama ovog zakona;</p>

<p>2.6. përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin e veprimtarisë në sport përfshirë përmbushjen e kushteve ligjore të kualifikimeve për trajner dhe instruktor;</p> <p>2.7. zbatimin e kushteve të parapara teknike dhe shëndetësore për të siguruar një ambient të sigurtë të zhvillimit të sportit;</p> <p>2.8. inspektime tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Për zbatimin e këtij ligji, inspektorati ka të drejtën e nxjerrjes së rekomandimeve për ndërmarrjen e veprimeve për evitimin e shkeljeve të caktuara, shqiptimin e gjobave dhe propozimin për pezullimin dhe ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me këtë ligj.</p> <p>4. Nëse gjatë inspektimit vërehet se autoriteti që inspektohet bënë shkelje të dispozitave të ligjit për të cilat janë në kompetencë të organit tjetër inspektues, Inspektorati i Sportit e raporton shkeljen në inspektoratin kompetent.</p> <p>5. Kundër vendimeve të Inspektoratit të Sportit, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Ministrinë përgjegjëse për Sport. Ankesa zgjidhet nga një</p>	<p>2.6. the fulfillment of the obligations for the exercise of activity in sports, including the fulfillment of the legal conditions regarding qualifications for coaches and instructors;</p> <p>2.7. implementation of technical and health conditions to ensure a safe environment for the practice of sports.</p> <p>2.8. other inspections determined by the legislation in force.</p> <p>3. For the implementation of this law, the inspectorate has the right to issue recommendations for the undertaking of actions to avoid certain violations, the imposition of fines and the proposal for the suspension and prohibition of the exercise of activity in accordance with this law.</p> <p>4. If during the inspection it is observed that the inspected authority violated the provisions of the law for which the other inspection body is competent, the Sports Inspectorate shall report the violation to the competent inspectorate.</p> <p>5. Against the decisions of the Sports Inspectorate, the dissatisfied party can file a complaint with the Ministry responsible for Sports. The complaint shall be resolved</p>	<p>2.6.ispunjenje obaveza za obavljanje sportske delatnosti, uključujući ispunjenje zakonskih uslova o kvalifikacijama za trenere i instruktore;</p> <p>2.7. sprovođenje predviđenih tehničkih i zdravstvenih uslova za obezbeđenje bezbednog ambijenta za razvoj sporta;</p> <p>2.8. druge inspekcije utvrđene važećim zakonima.</p> <p>3. Za sprovođenje ovog zakona inspektorat ima pravo da izda preporuke za preduzimanje radnji za izbegavanje određenih prekršaja, izricanje novčanih kazni i predlog za obustavu i zabranu obavljanja delatnosti u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>4. Ukoliko se prilikom inspeksijskog nadzora uoči da je organ koji se proverava prekršio odredbe zakona za koje je nadležan drugi inspeksijski organ, Sportska inspekcija o povredi prijavljuje nadležnom inspektoratu.</p> <p>5. Protiv odluke Sportske inspektorata, nezadovoljna strana može podneti žalbu Ministarstvu nadležnom za sport. Žalbu rešava stručna komisija od pet (5) članova</p>
---	--	---

<p>komision profesional prej pesë (5) anëtarë i krijuar nga Ministria.</p> <p>6. Inspektorati i Sportit zhvillon dhe miraton udhëzues për vlerësimin e rrezikut, planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve, dokumentimin e aktiviteteve inspektuese dhe raportimin për sektorin e sportit në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Këshilli Shtetëror për Sport</p> <p>1. Këshilli Shtetëror për Sport është organ këshillues me ekspertizë profesionale në fushën e sportit, i cili diskuton çështje të rëndësishme për sportin dhe ofron rekomandime për Ministrin përgjegjës për Sport.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror për Sport janë:</p> <p>2.1. propozimi i masave për përmirësimin dhe zhvillimin e sportit në Republikën e Kosovës;</p> <p>2.2. diskutimi dhe ofrimi i rekomandimeve lidhur me politikat dhe legjislacionin në fushën e sportit apo të ndërlidhur me sportin;</p>	<p>by a professional commission of five (5) members established by the Ministry.</p> <p>6. The Sports Inspectorate shall develop and approve guidelines for risk assessment, planning and coordination of inspections, documentation of inspection activities and reporting for the sports sector in accordance with the relevant legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 State Sports Council</p> <p>1. The State Sports Council is an advisory body with professional expertise in the field of sport, which discusses important sport issues and provides recommendations to the Minister responsible for Sport.</p> <p>2. The duties and responsibilities of the Sports Council are:</p> <p>2.1. proposing measures for the improvement and development of sports in the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. discussing and providing recommendations regarding policies and legislation in the field of sports or concerning sports;</p>	<p>koju formira Ministarstvo.</p> <p>6. Inspektorat za sport izrađuje i odobrava smernice za procenu rizika, planiranje i koordinaciju inspeksijskih nadzora, dokumentovanje inspeksijskih aktivnosti i izveštavanje za sektor sporta u skladu sa relevantnim zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Državni savet za sport</p> <p>1. Državni savet za sport je savetodavno telo sa stručnom ekspertizom u oblasti sporta, koje razmatra važna pitanja za sport i daje preporuke ministru nadležnom za sport.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Državnog saveta za sport su:</p> <p>2.1. predlaganje mera za unapređenje i razvoj sporta u Republici Kosovo;</p> <p>2.2. razmtranje i davanje preporuka koje se odnose sa politikama i zakonima u oblasti sporta ili u vezi sa sportom;</p>
---	---	--

